



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 22, datë 25.09.2024

P Ë R

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË HOTELERIE
DHE BANIMI 1, 2, 3 DHE 4 KATE MBI TOKË ME 1 KAT PARKIMI NËNTOKË”, ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN “BIZË”, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Iba Invest” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë hotelerie dhe banimi 1, 2, 3 dhe 4 kate mbi tokë me 1 kat parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Bizë”, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Iba Invest” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURZIMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 26/06 2025